



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 prill 2021
Nr. Ref.:RK 1747/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI82/20

Parashtrues

Jakup Mehmeti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me
Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-16-0144-A0001, të 21 shkurtit
2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Jakup Mehmeti (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Hamdi Podvorica, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-16-00144-A0001, të 21 shkurtit 2020 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DhPGjS), për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar AC-I-16-0144-A0001 të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, të 21 shkurtit 2020, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës], paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 [Mbrojtja e pronës] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 maj 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 qershor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese) Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 22 qershor 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Nga një kopje e kërkesës iu dërgua Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së dhe AKP-së.
8. Më 3 gusht 2020, AKP dorëzoi komentet e saj në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
9. Më 24 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri kërkoi që vendimmarrja të shtyhet për një datë tjetër për plotësime shtesë.
10. Më 3 mars 2021, Gjykata pranoi dosjen e plotë të lëndës nga DhPGjS.

11. Më 25 mars 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

1. Procedura e shpronësimit (eksproprijimit)

12. Më 26 prill 1982, Komuna e Ferizajt me Aktvendimin nr. 03-465-5 ka shpronësuar (eksproprijuar) paluajtshmërinë (ngastrën) nr. 111, me kulturë arë e klasit të tretë, në sipërfaqe prej 0.36,17 hektarë, e evidentuar në listën poseduese me nr.14-ZK-Talinocë i Jerlive, Komuna Ferizaj (në tekstin e mëtejme: paluajtshmëria kontestuese), për nevoja të Organizatës punuese IMK Fabrika për prodhimin e tubave. Përmes këtij Aktvendimi është urdhëruar Drejtoria për Pronësi, Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë ndryshimet në librat kadastral. Sipas shkresave të lëndës paluajtshmëria kontestuese ka kaluar në pronësi të N.Sh. Eurometal-KK-Ferizaj (Ligji në fuqi, G.Z. KSAK, i prillit 1978).
13. Nga viti 1982 e deri në vitin 2002, Gjykata nuk ka asnjë të dhënë se çfarë ka ndërmarrë parashtruesi i kërkesës deri në shpalljen e tij trashëgimtar të vetëm të pasurisë së babait Sh.M.

2. Procedura e trashëgimisë (jokontestimore)

14. Parashtruesi i kërkesës, në vitin 2002, kishte bërë kërkesë pranë Gjykatës Komunal në Ferizaj për shpalljen e tij trashëgimtar të tërë pasurisë së prindit SH.M., i cili kishte ndërruar jetë me 2 korrik 1999.
15. Më 12 dhjetor 2002, Gjykata Komunale në Ferizaj, me Vendimin T.nr.240/02, si gjykatë jokontestimore, e shpallë parashtruesin e kërkesës trashëgimtar të vetëm të tërë pasurisë së Sh.M., përkatësisht të ngastrave kadastrale me nr. 1, 136, 205, 490, 502/2, 647 dhe 648, në vendin e quajtur Oborrishtë me kulturë arë, livadh, shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të tërësishme prej 1.84,51 hektarë, e cila gjendet në fshatin Talinocë të Jerlive dhe evidentohet në fletën poseduese nr. 14 KK-Ferizaj.
16. Më 27 dhjetor 2002, Drejtoria për Pronësi, Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Ferizajt, sipas urdhrit të 12 dhjetorit 2002 të Gjykatës Komunale në Ferizaj, konstatoi se janë plotësuar kushtet ligjore për tu bërë ndryshimet e nevojshme në operatin kadastral, për bartjen e pasurisë, respektivisht ngastrave kadastrale me nr. 1, 136, 205, 490, 502/2, 647 dhe 648, në vendin e quajtur Oborrishtë me kulturë arë, livadh, shtëpi dhe oborr, në sipërfaqe të tërësishme prej 1.84,51 hektarë, sipas fletposedimit nr. 14 KK-Ferizaj, nga i ndjeri SH.M., tek i biri, përkatësisht parashtruesi i kërkesës.

3. Procedura pranë autoriteteve komunale

17. Më 18 gusht 2005, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në KK-Ferizaj, përmes së cilës kërkoi deeksproprijimin e paluajtshmërisë kontestuese me nr. 111, me kulturë arë e klasit të tretë në sipërfaqe prej 0.36,17 hektarë, e cila evidentohet më parë sipas fletposedimit nr. 14 KK-Ferizaj, fshati Talinocë i

Jerlive dhe kthimin e së njëjtës në posedimit të tij. Tutje në kërkesë thuhet: *“Ngastra e lartpërmendur, në bazë të Aktvendimit të lartpërmendur për eksproprijimin, është eksproprijuar për nevojat e Organizatës Punuese IMK - Fabrikës për prodhimin e tubave të çelitka në Ferizaj, për ndërtimin e një fabrike të re për prodhimin e gypave të nxehtësisë me ftohje ajrore, sipas projektit të paraparë. Ngastra tani evidentohet në emër të NSH "Eurometal", me seli në Ferizaj.”*

18. Në tetor 2005, Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër në Ferizaj, me vendimin nr. 06465-6, kishte refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për deeksproprijimin e paluajtshmerisë kontestuese dhe kthimin e së njëjtës në posedim të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se kërkesa për deeksproprijim dhe kthim në posedim të paluajtshmerisë kontestuese është bërë pas afatit të paraparë me nenin 21 të Ligjit për eksproprijim G.Z.-KSAK nr.1978 dhe 46/86.
19. Më 20 tetor 2005, parashtruesi i kërkesës, kundër vendimit të Drejtorisë për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër në Ferizaj, kishte ushtruar ankesë tek Kryeshefi Ekzekutiv i KK-Ferizaj, përmes së cilës, mes tjerash kërkoi: *“Kërkojmë nga Kryeshefi i Ekzekutivit që gjatë trajtimit të kërkesës tonë të këtë parasysh edhe faktin se rrethanat politike - ligjet diskriminuese të Serbisë të asaj kohe kanë qenë faktor që nuk është bërë kërkesa sipas afatit të paraparë në nenin 21 të Ligjit për Eksproprijimin dhe të marr Vendim për anulimin e Aktvendimit për eksproprijimin, të datës 23 prill 1982.”* Megjithatë në lidhje me këtë parashtrësë, parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi se si është vendosur tutje.
20. Më 8 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar me kërkesë Agjencionit Kadastral të Kosovës, përmes së cilës serish kërkoi deeksproprijimin dhe kthimin në posedim të paluajtshmerisë kontestuese. Megjithatë edhe në lidhje me këtë parashtrësë, parashtruesi nuk ka ofruar dëshmi se si është vendosur tutje.

4. Procedura pranë DhPGjS

21. Më 4 korrik 2005, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në DhPGjS, përmes së cilës kërkoi deeksproprijimin e paluajtshmerisë kontestuese dhe kthimin e saj në posedim të tij.
22. Më 27 korrik 2005, DhPGjS me Aktvendimin SCC-005-0209, e refuzon padinë e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se nuk ka juridiksion për të vendosur për këtë çështje, me arsyetimin, se vendimin sipas propozimit për eksproprijim e merr organi komunal i administratës, kompetent për punët pronësore-juridike në territorin e të cilit gjendet pasuria e patundshme në bazë të dispozitave të Ligjit mbi procedurën e përgjithshme administrative (neni 15 i Ligjit mbi eksproprijimin).

5. Procedura e likuidimit të ndërmarrjes N.Sh. Eurometal

23. Më 17 mars 2006, ndërmarrja shoqërore N.Sh. Eurometal-Ferizaj, iu nënshtrua procedurës së likuidimit nga ana e Autoritetit të likuidimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: AKM).
24. Më 5 qershor 2006, AKM, njofton parashtruesin e kërkesës se më 24 gusht 2005 ka hyrë në fuqi vendimi i bordit të AKM-së, për likuidimin e ndërmarrjes NSh. Eurometal-Ferizaj. Përmes këtij njoftimi parashtruesit të kërkesës i është dhënë afat deri më 12 qershor 2006 për të ushtruar ankesë në AKM.
25. Më 12 qershor 2006, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në AKM, përmes së cilës kërkoi kthimin e paluajtshmërisë kontestuese, duke u thirrur në ligjet diskriminuese dhe represionin e ushtruar ndaj pronës shqiptare nga regjimi i atëhershëm.

6. Padia pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj

26. Më 1 gusht 2006, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale në Ferizaj, për vërtetimin e pronësisë së paluajtshmerisë kontestuese, me arsyetimin se ai është i vetmi pronar legjitim i ngastrës nr. 111 në sipërfaqe prej 00.36,17 hektarë.
27. Më 3 maj 2012, Gjykata Komunale në Ferizaj, e shpall veten jokompetente për të vendosur përkitazi me çështjen juridike të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se: *"Gjykata pas shqyrtimit të padisë në kuptim të nenit 389 lidhur me nenin 392 pika (b) të Ligjit të procedurës kontestimore të Republikës së Kosovës, konstatoi se nuk ka juridiksion për të vendosur në këtë çështje juridike. Se kjo çështje juridike në pikëpamje lëndore është në kompetence të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe atë në bazë të nenit 4.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr. 04/LO33, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, i cili ligj ka hyrë në fuqi me dt. 01.01.2012"*.

7. Procedura pranë autoritetit të likuidimit të AKP-së

28. Më 21 maj 2013, Autoriteti i likuidimit të ish-AKM, tani AKP-së, kërkoi nga parashtruesi i kërkesës informata dhe dëshmi shtesë, si në vijim: 1) vërtetimin për kompensimin e paluajtshmërisë; 2) kopjen e ankesës ndaj Vendimit nr. 03-465-5, të 26 prillit 1982, lëshuar nga KK në Ferizaj; 3) një kopje të listës së librave kadastral që dëshmon se parcela është regjistruar në emër të parashtruesit të kërkesës; 4) fletëposedimin nr. 14; 5) dëshmi nëse parashtruesi i kërkesës ka kërkuar mbrojtje ligjore të të drejtave të tij; dhe 6) çdo dokument apo provë tjetër në mbështetje të kërkesës së tij.
29. Më 16 korrik 2013, AKP, me Vendimin GJIO57-0163, refuzoi si të pavlefshme ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke konsideruar se informatat e dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës ishin të pamjaftueshme për të mundësuar përfshirjen e tij në çfarëdo shpërndarje të të ardhurave nga likuidimi i ndërmarrjes N.Sh. Eurometal-Ferizaj.

8. Procedura përfundimtare pranë DhPGJS-së

30. Më 13 gusht 2013, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në DhPGjS, kundër Vendimit [GJIO57-0163] të Autoritetit të likuidimit të AKP-së, të 17 korrikut 2013, duke kërkuar anulimin e vendimit në fjalë, kthimin e paluajtshmërisë kontestuese në posedim dhe njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese, si dhe regjistrimin e së njëjtës në librat kadastral.
31. Më 18 mars 2014, DhPGjS informoi AKP-në, lidhur me ankesën e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës.
32. Më 29 prill 2014, AKP dorëzoi përgjigjen e saj në DhPGjS, me propozimin që DhPGjS të refuzojë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe të vërtetojë Vendimin [GJIO57-0163] e Autoritetit të likuidimit të AKP-së, sepse në bazë të nenit 21 të Ligjit për shpronësimin (Gazeta Zyrtare nr. 21/1978) parasheh që *“Kërkesa për anulim nuk mund të parashtrohet 10 (dhjetë) vjet pasi ka hyrë në fuqi Vendimi për shpronësim.”*, dhe se nuk ka dëshmi se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar anulimin e Vendimit nr. 03-465-5, të 26 prillit 1982 në DhPGjS, deri në vitin 2005.
33. Më 11 qershor 2014, parashtruesi i kërkesës në DhPGjS dorëzoi përgjigje ndaj pretendimeve të AKP-së, duke theksuar se argumentet e AKP-së janë tërësisht të kundërligjshme, andaj të refuzohen nga DhPGjS si të pabazuara.
34. Më 19 maj 2016, Kolegji i specializuar i DhPGjS-së, përmes Vendimit C-IV-13-1528, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Vendimin [GJIO57-0163] e Autoritetit të likuidimit të AKP-së, të 16 korrikut 2013, si të drejtë dhe të bazuar në ligj, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës për anulimin e Aktvendimit për eksproprijimin nuk i është drejtuar organeve administrative të komunës përkatëse, që e ka bërë shpronësimin e paluajtshmërisë kontestuese.
35. Më tutje, në arsyetim theksohet: *“Për më tepër, Dhoma e Posaçme konsideron se para fillimit të procedurave për kthimin e pasurisë së patundshme të ekspropriuar, ankuesi duhet që fillimisht t’iu ishte drejtuar organeve administrative. Sipas nenit 39 të Ligjit mbi eksproprijimin (037/L-139) del se kjo çështje duhet të zgjidhet nga ana e organeve administrative dhe sipas procedurës së sipërcituar në këtë Ligj, Kërkesa për shqyrtim gjyqësor të vendimit të tillë bazohet në nenin 27.2 të këtij Ligji që do të thotë se vendimi i tillë mund të apelohe vetëm në kuadër të departamentit për çështje administrative pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës, në përputhje me Ligjin (nr. 03/L-202) për konfliktet administrative. Pa eliminimin e efekteve ligjore të vendimit mbi eksproprijimin, të marrë në vitin 1982, ankuesi nuk mund të konsiderohet pronar i paluajtshmërisë dhe si pasojë ai nuk është në gjendje të kërkojë kthimin e pasurisë së paluajtshme e cila është marrë nga ai me këtë vendim”*.
36. Më 27 qershor 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DhPGjS-së, ndaj vendimit të Kolegjit të Specializuar, të 19 majit 2016, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit material dhe procedural, me propozimin që ankesa të aprovohet si e bazuar

dhe Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar, C-IV-13-1528, i 19 majit 2016 të ndryshohet.

37. Më 21 shkurt 2020, Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, me Aktvendimin AC-II-16-0144-A0001, e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C-IV-13-1528] e Kolegjit të Specializuar, të 6 qershorit 2016.
38. Pjesë relevante nga arsyetimi i Aktvendimi të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së:

“Kolegji i Apelit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, pas vlerësimit të ligjshmërisë së aktgjykimit të ankimuar, si dhe duke u bazuar në provat në dosje të lëndës gjeti se aktgjykimi i atakuar është i drejtë, është i bazuar dhe i arsyetuar mirë. Paditësi kishte dështuar të iniciojë procedurë administrative për çështjen kontestuese, për kundërshtimin e këtij vendimi. Konform nenit 17 të Ligjit mbi Eksproprijimin, kundër vendimit të organit komunal i cili e ka bërë eksproprijimin mund të paraqitet ankesë pranë organit kompetent në shkallë të dytë. Nga provat në shkresat e lëndës, nuk shihet asnjë indikacion që ky vendim të jetë kundërshtuar nga paditësi.

Sipas nenit 21, paragrafi 4 i këtij ligji, vendimi mbi eksproprijimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të mëparshëm të pasurisë së ekspropriuar, nëse shfrytëzuesi i ekspropriimit në afat prej 3 vitesh nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit punimet të nevojshme në atë objekt. Paragrafi 5 i këtij neni përcakton se pas kalimit të 10 vjetëve nga dita kur një vendim i tillë ka marrë formën e prerë, nuk mund të paraqitet kërkesa për anulim. Kolegji i Apelit konstaton se padia për anulimin e këtij vendimi për herë të parë është paraqitur më 12 qershor 2006 në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që do të thotë, jashtë të gjitha afateve të përcaktuara me ligj.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktvendimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 dhe 46, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, duke pretenduar se paluajtshmëria kontestuese i është shpronësuar pa i dhënë atij një siguri si pronar.
40. Parashtruesi i kërkesës shkeljen e nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës, e ndërlikohet me konkluzionin e kolegeve të DhPGjS-së, të cilat sipas tij konstatuan gabimisht se *“Ligji mbi eksproprijimin parasheh se një kërkesë e tillë nuk mund të parashtrohet pas kalimit të afatit prej 10 vjetësh, është e gabuar sepse legjitimon privimin në mënyrë arbitrare të pronarit nga prona dhe me dispozitat kushtetuese se e drejta e pronës është e garantuar”*.
41. Mbi këtë bazë parashtruesi i kërkesës shton se, *“Sipas nenit 49.1. të Ligjit mbi ekspropriimin, të aplikueshëm në kohën e ekspropriimit (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, nr. 21/1978), “pasi të merr formë të prerë vendimi mbi ekspropriimin, organi komunal i administratës, kompetent për punë juridike-pasurore është i obliguar që pa vonesë të fillojë procedurën e*

kompensimit të pronarit të pronës së ekspropriuar, Sipas nenit 140.1 të LPJK procedura e shpronësimit të pasurisë se shpronësuar fillon dhe zhvillohet sipas, detyrës zyrtare. Por ky konstatim rezulton edhe nga dispozita e nenit 217.1 të LPJK-së,... Në rastin konkret organi kompetent nuk e ka filluar procedurën e kompensimit me marrëveshje e as nuk i ka dërguar shkresat e lëndës gjykatës kompetente ...”.

42. *Tutje, parashtuesi i kërkesës shton se: “Afati i parashkrimit të kërkesës për kompensimin e drejtë për pasurinë e paluajtshme e cila kalon në pronësi shoqërore sipas bazës së shpronësimit, ose bazës tjetër ligjore, ku kompensimi caktohet sipas detyrës zyrtare fillon të ec që nga dita e parë, pas datës kur pronari i mëparshëm i pasurisë së paluajtshme ka pasur të drejtë të kërkojë kompensimin e drejtë të caktuar me marrëveshje ose me vendim të gjykatës. Për faktin se kompensimi i tillë paditësit nuk iu ka caktuar as me ujdë të arritur pranë organit administrativ e as me vendim të gjykatës, prandaj, këtu nuk ka mundur as të fillojë të rrjedhë afati i parashkrimit të kërkesës së tillë, andaj Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, gabimisht kanë zbatuar dispozitat ligjore të referuara në aktgjykimet e tyre, kur kanë gjetur se kërkesa e paditësit është e pabazuar”.*
43. *Për më tepër, parashtuesi i kërkesës thekson se: “Njëjtë është situata edhe sa i përket kthimit të pasurisë së ekspropriuar të pronarit të mëparshëm. Sipas par. katër të nenit 21 të Ligjit mbi ekspropriimin i cili ka qenë në fuqi në kohën e ekspropriimit vendimi në formë të prerë mbi ekspropriimin, do të anulohet, nëse shfrytëzuesi i ekspropriimit në afatin prej 3 vjetësh, prej se vendimi ka marrë formën e prerë nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit punimet e nevojshme në atë objekt. Shfrytëzuesi i ekspropriimit lëre që nuk ka kryer punimet e nevojshme në atë objekt në afatin e paraparë prej 3 vjetësh, por as sot e kësaj dite ato nuk janë kryer. Pronari i patundshmërisë së ekspropriuar vazhdimisht ka bërë kërkesa gojore për anulimin e vendimit të ekspropriimit të patundshmërisë por kërkesat e tij nuk janë marrë parasysht. Për këtë arsye, pronari i patundshmërisë i është drejtuar edhe gjykatës me padi për realizimin e të drejtës të pakontestueshëm të tij në patundshmëri mirëpo edhe gjykata deri tani nuk ka vendosur në favor të pronarit të patundshmërisë së ekspropriuar, për shkak se është shpallur inkompetente”.*
44. *Në fund, parashtuesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: “I. Ta deklarojë kërkesën e pranueshme për shqyrtim në merita: II. Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm) dhe të nenit 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 1 të Protokollit shtojcë të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore. III. Shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme C-IV-13-1528 të datës 06 prill 2016 dhe Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-16-0144A0001 të datës 21 shkurt 2020. IV. Ta kthejë Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, C-IV-131528 të datës 06 prill 2016 dhe Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-I-16-Q144-A0001 të datës 21 shkurt 2020, për rishqyrtim në pajtim me aktgjykimin e kësaj gjykate. V.*

Urdhërohet Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që në pajtim me rregullin 66 (5) të Rregullores së punës ta njoftoi gjykatën brenda 6 muajsh nga publikimi i këtij aktgjykimi, lidhur me masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimit të kësaj gjykate”.

Pranueshmëria e kërkesës

45. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
46. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, qe përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

47. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

48. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin AC-II-16-0144-A0001 të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, të 21 korrikut 2020, pasi i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Parashtuesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
49. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

50. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 dhe 46, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës, si dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, duke i ndërlidhur pretendimet e tij me mënyrën e aplikimit të ligjit në fuqi në kohën e shpronësimit (eksproprijimit) të paluajtshmërisë kontestuese. Andaj, Gjykata do t'i shqyrtojë dhe vlerësojë pretendimet e parashtuesit të kërkesës në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 53 të Kushtetutës, që përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

i. Përkitazi me pretendimin për shkelje të “gjykimit të drejtë” si rezultat i aplikimit të gabuar të ligjit të aplikueshëm

51. Sa i përket këtij pretendimi të parashtuesit të kërkesës, se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, sepse gabimisht u aplikuan dispozitat e përkatëse të ligjit të aplikueshëm (Gazeta Zyrtare, nr. 21/1978), Gjykata konsideron se pretendimet e këtilla ngrenë çështje të ligjit (ligjshmërisë) dhe jo çështje kushtetuese (kushtetutshmërisë). Në lidhje me këtë, Gjykata në mënyrë të përsëritur ka theksuar se, si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretim dhe zbatim të gabuar të dispozitave të ligjit, që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund të shqyrtojë ato (shih rastet e Gjykatës: nr. K106/17, parashtues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; K1122/16, parashtues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe rastin e Gjykatës K1154/17 dhe K105/18, parashtues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me*

përgjegjësi të kufizuar “Barbas”, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 gushtit 2019, paragrafi 60).

52. Në mënyrë konsistente, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GjEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 37; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 61).
53. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, e që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GjEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58 dhe KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 62).
54. Megjithatë, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GjEDNJ ka theksuar se përderisa autoritetet vendore kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në (shih, rastin e GjEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
55. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës (përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
56. Në këtë aspekt, Gjykata duhet të theksojë se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar para Gjykatës (i) arsyet të cilat do të mund të mbështesin pretendimin se në rrethanat e rastit konkret, nenet përkatëse të ligjit të aplikueshëm, janë interpretuar nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së në “*mënyrë qartazi të gabuar*”; dhe (ii) se si një interpretim i tillë, ka rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin e kërkesës.

57. Gjykata në vazhdim, vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me aplikimin e gabuar të dispozitave të Ligjit nr. 21/1978, janë adresuar fillimisht nga Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, ku theksohet se: *“Procedura e eksproprijimit ishte zbatuar në bazë të Ligjit për shpronësim G.z, e KSAK, prill 1978, i cili atëherë ishte në fuqi dhe kjo është procedurë administrative e jo procedurë gjyqësore. Procedura e eksproprijimit, mënyra, obligimet e shfrytëzuesit të eksproprijimit dhe të drejtat e pronarit prona e të cilit eksproprijohet është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për eksproprijimin, kështu që për realizimin e çdo të drejte të tij pronari i pronës që eksproprijohet këto të drejta duhet t’i realizoj në atë procedurë dhe pranë organeve administrative, të cilat e zhvillojnë këtë procedurë”*.
58. Kolegji i specializuar, tutje arsyetoi se: *“Marrja e vendimit, ankimimi si dhe anulimi i vendimit mbi eksproprijimin është kompetencë ekskluzive e organeve të administratës shtetërore dhe e tërë kjo procedurë rregullohet me Ligjin mbi eksproprijimin, teksti i spastruar (nenet 15, 17 dhe 21 par. 6 i këtij Ligji). Neni 21 par. 6 i të njëjtit ligj përcakton se: “në lidhje me Kërkesën për anulimin e vendimit mbi eksproprijimin dhe heqjen dorë nga propozimi për eksproprijim vendos organi i cili ka vendosur në shkallë të parë në lidhje me propozimin për eksproprijim”. Bazuar në dispozitat e Ligjit mbi eksproprijimin e vetmja çështje për të cilën janë kompetente gjykatat është çështja e kompensimit të drejtë - caktimit të lartësisë së shpërblimit por kjo çështje nuk është ngritur nga ankuesi”*.
59. Përkitazi me kthimin e paluajtshmerisë kontestuese të shpronësuar, Gjykata gjithashtu vëren se Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, arsyetoi: *“Ankuesi kishte kërkuar kthimin e pronës së eksproprijuar me arsyetim se ajo nuk është përdorur për qëllimin i cili është ven në dukje në vendimin mbi eksproprijimin. Në lidhje me këtë, Dhoma e Posaçme vëren se ankuesi është thirrur në nenin 21 të Ligjit mbi eksproprijimin në bazë të të cilit pronari i mëparshëm e kërkon kthimin e pronës së paluajtshme të eksproprijuar nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit në afatin prej tri vitesh, prej datës kur vendimi ka marrë formën e prerë nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit, punimet e nevojshme në atë objekt. Paragrafi tjetër i këtij neni përcakton se një kërkesë e tillë nuk mund të parashtrohet pas kalimit të afatit prej 10 viteve. Në mënyrë të ngjashme kjo çështje është e rregulluar edhe me dispozitat e Ligjit të tashëm mbi eksproprijimin (nr. 03/L-139) në nenin 27. Që nga shpronësimi në fjalë që është kryer në vitin 1982, mundësia për t’u thirrur në këtë mjet juridik ka kaluar në vitin-1992”*.
60. Në fund, Kolegji i specializuar i DhPGjS-së, përfundon: *“Për më tepër, Dhoma e Posaçme konsideron se para fillimit të procedurave për kthimin e pasurisë së patundshme të eksproprijuar, ankuesi duhet që fillimisht t’iu ishte drejtuar organeve administrative. Sipas nenit 39 të Ligjit mbi eksproprijimin (037/L-139) del se kjo çështje duhet të zgjidhet nga ana e organeve administrative dhe sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj. Kërkesa për shqyrtim gjyqësor të vendimit të tillë bazohet në nenin 27.2 të këtij Ligji që donë të thotë se vendimi i tillë mund të apelohe vetëm në kuadër të departamentit për çështje administrative pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës, në përputhje me Ligjin (nr.03/L-202) për konfliktet administrative. Pa eliminimin e*

efekteve ligjore të vendimit mbi eksproprijimin, të marrë në vitin 1982, ankuesi nuk mund të konsiderohet pronar i paluajtshmërisë dhe si pasojë ai nuk është në gjendje të kërkoj kthimin e pasurisë së paluajtshme e cila është marrë nga ai me këtë vendim”.

61. Gjykata vëren se pretendimeve të përsëritura të parashtruesit të kërkesës i është përgjigjur edhe Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, duke theksuar: *“Kolegji i Apelit pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, pas vlerësimit të ligjshmërisë së aktgjykimit të ankimuar, si dhe duke u bazuar në provat në dosje të lëndës gjeti se aktgjykimi i atakuar është i drejtë, është i bazuar dhe i arsyetuar mirë. Padiësi kishte dështuar të iniciojë procedurë administrative për çështjen kontestuese, për kundërshtimin e këtij vendimi. Konform nenit 17 të Ligjit mbi Eksproprijimin, kundër vendimit të organit komunal i cili e ka bërë eksproprijimin mund të paraqitet ankesë pranë organit kompetent në shkallë të dytë. Nga provat, shkresat e lëndës, nuk shihet asnjë indikacion që ky vendim të jetë kundërshtuar nga padiësi”.*
62. Për më tepër, Kolegji i Apelit të DhPGjS-së, arsyetoi se: *“Sipas nenit 21, paragrafi 4, i këtij ligji, vendimi mbi eksproprijimin do të anulohet edhe në bazë të kërkesës së pronarit të mëparshëm të pasurisë së eksproprijuar, nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit në afat prej 3 vitesh nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit punimet të nevojshme në atë objekt. Paragrafi 5 i këtij neni përcakton se pas kalimit të 10 vjetëve nga dita kur një vendim i tillë ka marrë formën e prerë, nuk mund të paraqitet kërkesa për anulim”.*
63. Në fund, Kolegji i Apelit të DhPGjS-së, konstatoi *“se padia për anulimin e këtij vendimi për herë të parë është paraqitur më 12 qershor 2006 në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që do të thotë, jashtë të gjitha afateve të përcaktuara me ligj”.*
64. Gjykata më tej rithekson se, në parim, *“drejtësia”* që kërkohet me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së nuk është drejtësi *“substanciale”*, por drejtësi *“procedurale”*. Në terma praktikë, dhe në parim, kjo shprehet me procedurë kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para gjykatës përkatëse (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI42/16, parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; KI118/18, me parashtrues *Eco Construction sh.p.k*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shtatorit 2019, paragrafi 48; dhe KI49/19, parashtrues: *Limak Kosovo International Airport SH.A.*, *“Adem Jashari”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 janarit 2020, paragrafi 55).
65. Kjo nënkupton, se palëve duhet mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit; duhet akorduar mundësia që gjatë fazave të ndryshme të procedurës palët të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë relevante për rastin përkatës; se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që janë relevante për zgjidhjen e një rasti janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura janë shtruar dhe arsyetuar hollësisht dhe se, në

përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI118/17, parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 shkurtit 2018, paragrafi 35; po ashtu shih, *mutatis mutandis*, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 29). Gjykata konsideron, se në rrethanat e rastit konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se ky nuk është rasti.

66. Më tej dhe në fund, Gjykata thekson se neni 6 i KEDNj-së, në një proces gjyqësor, nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm, sepse njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
67. Nga si u cek më sipër, Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ka respektuar kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, duke i dhënë mundësi parashtruesit të kërkesës, sikundër edhe palëve të tjera në procedurë, që t'i paraqesë kundërshtimet e tij përkitazi me çështjen e parashtruar pranë DhPGjS-së. Për më tepër, të gjitha argumentet, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të parashtruesit të kërkesës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga kolegji në fjalë; se arsyet faktike e ligjore ndaj aktvendimit të kontestuar janë shtruar dhe arsyetuar hollësisht dhe se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk ishin të padrejta dhe qartazi arbitrare.
68. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se nuk ka asgjë që tregon se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*", aplikim i cili do të mund të rezultonte në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës.

ii. Përkitazi me pretendimin për shkelje të të drejtave pronësore

69. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës së pronës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës edhe këtë pretendim e ndërlidhë me mënyrën e aplikimit të ligjit, GZ. nr. 21/1978, i cili ka qenë në fuqi në kohën e shpronësimit (eksproprijimit) të paluajtshmerisë kontestuese.
70. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se "*Ligji mbi eksproprijimin parasheh se një kërkesë e tillë nuk mund të parashtrohet pas kalimit të afatit prej 10 vjetësh, është e gabuar sepse legjitimon privimin në mënyrë arbitrare të pronarit nga prona dhe me dispozitat kushtetuese se e drejta e pronës është e garantuar*".
71. Gjykata së pari rikujton përmbajtjen e nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, të cilat në lidhje me të drejtat pronësore përcaktojnë:

Neni 46
[Mbrotjtja e Pronës]

“1. E drejta e pronës është e garantuar.

2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.

3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente. [...].”

KEDNj

Protokollit nr. 1 neni 1 [Mbrojtja e pronës]

“1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.”

Parimet e përgjithshme

72. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata së pari thekson se paragrafi 1 i nenit 46 të Kushtetutës e garanton të drejtën e pronës; paragrafi 2 i nenit 46 të Kushtetutës përcakton mënyrën e shfrytëzimit të pronës, duke specifikuar qartë se shfrytëzimi i saj rregullohet me ligj dhe në pajtim me interesin publik dhe paragrafi 3 i nenit 46 të Kushtetutës garanton që askush nuk mund të privohet nga prona në mënyrë arbitrare, duke përcaktuar gjithashtu kushtet në të cilat prona mund të shpronësohet (shih, *mutatis mutandis*, rasti KI50/16, parashtrues i kërkesës Veli Berisha dhe të tjerët, Aktvendimi për papranueshmëri, i 10 marsit 2017, paragrafi 31).
73. Sa i përket të drejtave të garantuara dhe të mbrojtura me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së, Gjykata rithekson se neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNj-së përbëhet nga tri rregulla të dallueshme dhe të ndërlidhura: rregulli i parë shpreh parimin e gëzimit paqësor të pronës; rregulli i dytë trajton privimin nga pasuria dhe ia nënshton atë kushteve të caktuara; dhe, rregulli i tretë, ua njeh të drejtën shteteve që të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, duke zbatuar ligje të tilla që ato i çmojnë si të nevojshme për arritjen e një qëllimi (shih *mutatis mutandis*, rastet e GjEDNj-së: *Sporrong dhe Lonnrot kundër Suedisë*, Aktgjykimi i 23 shtatorit 1982, ankesa nr. 7151/75; 7152/75, paragrafi 61; *James, Wells dhe Lee kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ankesat nr. 25119/09, 57715/09 dhe 57877/09, 18 shtator 2012; *Sargsyan kundër Azerbaixhan*, ankesa nr. 40167/06, 16 qershor 2015; dhe *Belane Nagy kundër Hungarisë*, ankesa nr. 53080/13, i 13 dhjetorit 2016).

74. Gjykata rikujton se të tri rregullat nuk janë, megjithatë, “të ndryshme” në kuptimin e të qenurit të pandërlidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën për gëzimin paqësor të pronës dhe prandaj duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullin e parë (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 21 shkurtit 1986, *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8793/79, paragrafi 37).
75. Sa i përket rregullit të parë, GjEDNJ vazhdimisht ka konstatuar se koncepti i “pasurisë” i cili bën pjesë në pjesën e parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është një koncept autonom, që përfshin si “pasuritë ekzistuese” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshmëri legjitime”. “Pasuritë” sipas këtij koncepti përfshijnë të drejtat “*in rem*” dhe “*in personam*”, siç është pasuria e paluajtshme, e luajtshme dhe interesat e tjera pronësore.
76. Koncepti autonom i “pasurisë” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është i pavarur nga klasifikimi thjesht formal në ligjin vendor dhe nuk është i kufizuar në pronësinë e të mirave fizike: disa të drejta dhe interesa të tjera që përbëjnë “asete” mund të konsiderohen gjithashtu si “të drejta pronësore”, dhe kështu si “pasuri” për qëllimet e kësaj dispozite. Çështja që duhet të shqyrtohet në secilin rast veç e veç është nëse rrethanat e rastit, të marra si një tërësi, i janë dhënë parashtruesit të kërkesës si një e drejtë me interes thelbësor të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së (shih, *Depalle kundër Francës* [GC], paragrafi 62; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [DHM], paragrafi 63; *Öneryıldız kundër Turqisë* [DHM], paragrafi 124; *Broniowski kundër Polonisë* [DHM], paragrafi 129; *Beyeler kundër Italisë* [DHM], paragrafi 100; *Iatridis kundër Greqisë* [DHM], paragrafi 54; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano kundër Italisë* [DHM], paragrafi 171; *Fabris kundër Francës* [DHM], paragrafi 49 dhe 51; *Parrillo kundër Italisë* [DHM], paragrafi 211; *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 76).
77. Koncepti i “pasurisë” dhe i “pritjeve legjitime” kanë një vend qendror në interpretimin e të drejtave pronësore të garantuara me KEDNJ dhe të zhvilluara më tej me praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së. Nga ana tjetër, “pritjet legjitime mund të rezultojnë në pasuri”. Edhe pse neni 1 i Protokollit nr. 1 i KEDNJ-së zbatohet vetëm për pasurinë ekzistuese të një personi dhe nuk krijon të drejtën e fitimit të pronës, në rrethana të caktuara, një “pritje legjitime” për fitimin e një prone mund të gëzojë gjithashtu mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 13 dhjetorit 2016, *Bélané Nagy kundër Hungarisë*, nr. 53080/13, para. 73 dhe 75, Aktgjykimi i GjEDNJ-së i 22 qershorit 2004, *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 34443/96 paragrafi 129).
78. Në mënyrë që një “pritshmëri” të jetë “legjitime”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete sesa thjesht një shpresë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt juridik siç është një vendim gjyqësor, që paraqet një interes të pronës në fjalë (shih, *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], paragrafit 49-50; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [DHM], paragrafi 173; *Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, paragrafi 103; *Ceni kundër Italisë*,

paragrafi 39; dhe *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 75). Në të kundërtën, asnjë “pritje legjitime” nuk mund të thuhet se lind, kur ka një mosmarrëveshje sa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të ligjit vendor dhe kur kërkesat e parashtruesve më pas refuzohen nga gjykatat kombëtare (shih, *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], paragrafi 65; *Centro Europa 7 SRL dhe di Stefano v. Italy* [DHM], paragrafi 173; *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [DHM], paragrafi 75; *Karachalios kundër Greqisë* (vendim), paragrafi 46; *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [DHM], paragrafi 149).

Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret

79. Fillimisht, Gjykata rikujton se ajo nuk gjeti shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për aplikim të gabuar dhe arbitrar të ligjit në fuqi. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme të së drejtës në pronë dhe pasi analizoi pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje shkeljen e kësaj të drejte, vlerëson se parimet e lartcekura nuk janë të aplikueshme në rastin e parashtruesit të kërkesës, për arsyet që do i shtjellojë në vijim.
80. Gjykata vë në pah se ankesat/kërkesat e parashtruesit të kërkesës u refuzuan nga kolegjet e DhPGjS-së për shkaqe thjeshtë procedurale, sepse parashtruesi i kërkesës brenda afateve ligjore nuk kishte shfrytëzuar mundësinë e kontestimit të vendimit [nr.03-465-5] të KK-Ferizaj, të 26 prillit 1982, me të cilin paluajtshmëria kontestuese ishte shpronësuar (eksproprijuar) nga KK-Ferizaj dhe as nuk kishte bërë kërkesë pranë DhPGjS-së për kompensimin e drejtë, për të përfutur nga likuidimi i N.Sh. Eurometal-Ferizaj (shih, paragrafin 28 të këtij dokumenti).
81. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i DhPGjS-së, theksoi se: *“Pa eliminimin e efekteve ligjore të vendimit mbi eksproprijimin, të marrë në vitin 1982, ankuesi nuk mund të konsiderohet pronar i paluajtshmërisë dhe si pasojë ai nuk është në gjendje të kërkojë kthimin e pasurisë së paluajtshme e cila është marrë nga ai me këtë vendim”*. Ky konkluzion është pranuar dhe nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së.
82. Nga si më sipër, Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk kemi të bëjmë me një të drejtë pronësore të fituar me një vendim gjyqësor të formës së prerë dhe as me pritje legjitime, sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka një të drejtë të pohueshme, me të cilën dëshmon dhe provon se ai gëzon të drejtën e kthimit të së drejtës së pronës së paluajtshmërisë kontestuese. Për më tepër, të gjitha kërkesat e tij për deeksproprijim dhe kthimin në posedim të paluajtshmërisë kontestuese ishin të pasuksesshme (shih, ngjashëm, *GjEDNj rasti Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], parimin e paraqitur në paragrafin 52). Në këtë rrethanë, parashtruesi i kërkesës nuk mund të pretendojë shkelje të të drejtave të tij pronësore, përderisa kolegjet e DhPGjS-së, në rastin e tij shqyrtuan vetëm aspektet procedurale të ankesës/kërkesës së tij, përkitazi me kërkesat për deeksproprijim dhe kthimin në posedim të paluajtshmërisë kontestuese.

83. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se ajo vetë nuk mund të shndërrohet në gjykatë të faktit, dhe të vendos për rikthimin në posedim të një prone të shpronësuar ose për vërtetimin e pronësisë, sepse një kompetencë e tillë, si rregull, iu takon gjykatave të rregullta ta bëjnë. Për me tepër, me asnjë vendim gjyqësor nuk konfirmohet se Aktvendimi [nr.03-465-5] i KK-Ferizaj, i 26 prillit 1982, më të cilin është bërë ekspropriimi i paluajtshmërisë kontestuese është anuluar ose është shpallur i pavlefshëm. Gjykata rikujton se ajo mund të ndërhyjë vetëm atëherë kur parashtruesve të kërkesave iu është njohur e drejta e pronësisë me një vendim gjyqësor përfundimtar ose me ligj dhe zbatim i një të drejte të fituar nuk ka gjetur zbatim në praktikë (shih, më lartë, parimet e përgjithshme, në paragrafin 77 të këtij dokumenti).
84. Andaj, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës thjeshtë është i pakënaqur me rezultatin e procedurës në gjykatat e rregullta, andaj pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNJ-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).
85. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës në pronë është qartazi i pabazuar nga arsyet e lartcekura.

Përfundim

86. Si përmbledhje, Gjykata duke u mbështetur në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij, për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nenin 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
87. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, andaj në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, e njëjta duhet deklaruar e papranueshme.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 25 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi